VENDIM
Nr.40, datë 16.1.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.191, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE SHTETËRORE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE ME KONCESION"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Oponenca teknike shtetërore për projektet e parashikuara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet nga një grup ekspertësh të shquar në fushën e inxhinierisë hidroteknike, hidrologjike, gjeologjike dhe të mjedisit. Ky grup nuk do të ketë më shumë se 18 ekspertë dhe emërimi i tyre bëhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Mënyra e funksionimit të grupit përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.".

2. Pikat 3 e 4 përmblidhen në një pikë të vetme, me numrin 3, me këtë përmbajtje:

"3. Grupi i ekspertëve bën vlerësimin tekniko-mjedisor të projekteve, duke synuar shfrytëzimin optimal të burimeve ujore. Grupi i ekspertëve, me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryen oponencën për çdo projektpropozim dhe, pas përfundimit të oponencës, harton raportin përkatës të vlerësimit tekniko-mjedisor të tij. Materiali i oponencës dërgohet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për vazhdimin e procedurave. Gjithashtu, me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, grupi i ekspertëve kryen studime në fushën hidroenergjetike.".

3. Pikat 5 e 6 numërtohen, përkatësisht, 4 e 5.

4. Pika 7 numërtohet pika 6 dhe ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Pagesa e grupit të ekspertëve, për periudhën 1 janar deri në 1 korrik 2008, të përballohet nga fondet operative, të miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në shumën 10 758 000 (dhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë.".

5. Pika 8 shfuqizohet dhe pika 9 e vendimit numërtohet 8.

6. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha